



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi Komunal Dragash
Skupstina Opstina Dragas
Municipal Assembly Dragash

-Kuvendi Komunal Dragash

01,Nr.06-22/1

Dragash,05.03.2009

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale Nr.03/L-040, neni 12.2 qëndrim d) , në Ligjin mbi tokën bujqësore Nr.02/L-26 dhe neni 68 qëndrim d) të Statutit të komunës së Dragashit të miratuar nga Asambleja Komunale në seancën e mbajtur më 11.09.2008, miraton këtë:

RREGULLORE

MBI RUAJTJEN E TOKES BUJQËSORE

I DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohet qeverisja, shfrytëzimi racional, mbrojtja e tokës bujqësore dhe mbrojtja e pasurive bujqësore në territorin e komunës së Dragashit.

Neni 2

Tokë bujqësore sipas kësaj Rregulloreje konsiderohet çdo arë e shfrytëzuar ose e pa shfrytëzuar, kopsht, livadh, kullose etj si dhe toka tjetër e cila sipas destinimit të vet, më së shumti do të shërbente interesave të përgjithshme në prodhimtarinë bujqësore.

Toka ndërtimore mund te shfrytëzohet për prodhimtarinë bujqësore deri sa mos te filloi ndërtimi I objekteve ndërtimore.

Neni 3

Toka bujqësore si pasuri me interes te përgjithshëm shfrytëzohet vetëm për prodhimtarinë bujqësore dhe gëzon mbrojtjen e veçantë.

Neni 4

Shfrytëzimi racional I tokës bujqësore është me interes te përgjithshëm. Shfrytëzuesve nuk u lejohet që tokën bujqësore ta mbajnë te pa punuar ,dhe qe me rastin e punimit t'i zbatojnë masat agroteknike dhe agro melioruese.

Neni 5

Pronari i tokës bujqësore obligohet që tokën bujqësore ta shfrytëzoj në mënyrë racionale dhe se paku ta punoj ne mënyrën e rëndomtë si qe punohet ajo ne territorin e komunës.

Pronari i tokës bujqësore me rastin e punimit te tokës obligohet te aplikoi masat agroteknike dhe masat tjera, afatet optimale, përdorimin e farës se kultivarit cilësor etj.

Neni 6

Pronari i tokës bujqësore gjate punimit te tokës se vet bujqësore obligohet qe sa me pak te shkaktoj dëme fqinjëve te vete.

Neni 7

Pronari I tokës bujqësore te cilit i pengohet hyrja ne tokën e vet bujqësore ka te drejte qe te kërkoi kalimin neper tokën fqinjëve në vëllim kohor te nevojshëm për punimin dhe shfrytëzimin racional te tokës bujqësore.

II SHFRYTEZIMII TOKES BUJQËSORE PER QELLIME JOBUIQËSORE

Neni 8

Toka bujqësore e klasës I,II,III,dhe IV nuk mund te përdoret për qëllime jobujqësore.

Përfundimisht nga alineja e parë e këtij neni nëse ndërtimi I objekteve ekonomike është planifikuar me plan urbanistik ose me Vendim i cili e zëvendëson atë plan, e sipas natyrës dhe procesit teknologjik objekti duhet te ndërtohet pranë bazës së lëndës së parë, ose ndërtimi i objekteve të standardit shoqëror që është I lidhur me vendbanimin si shkollat, shtëpitë, çerdhet, ambulancat etj.

Neni 9

Ndërrimi i përhershëm i destinimit të tokës bujqësore të klasës 5 deri 6 do të bëhet me vendimin e Kuvendit Komunal.

Ndërrimi i përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore të klasës 1 deri 6 do të bëhet me pëlqim urbanistik.

Ndërrimi i përhershëm dhe i përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore të klasës 7 deri 8 do të bëhet me pëlqim urbanistik. Atë do ta lëshoj organi i planifikimit me pëlqimin e organit për bujqësi. Pëlqimi nga organi për bujqësi do të jepet në formë të vendimit të shkruar i cili do të ketë arsyet .

Me rastin e shqyrtimit të planit urbanistik ose Vendimit I cili e zëvendëson këtë plan kuvendi I komunës duhet te ketë parasysh ruajtjen e tokës së pëlleshme bujqësore, në mënyrë që te mos zvogëlohet fondi I tokës bujqësore.

Neni 10

Para ndërtimit të objekteve ndërtimore duhet të kompletohen të gjitha dokumentet nga parashtruesi i kërkesës .

Parashtruesi i kërkesës për ndërrimin e destinimit duhet të paraqes informatat dhe dokumentacionin si vijon:

- a) Planin e lokacionit në përpjesëtim 1/500;
- b) Pozitën dhe numrin e parcelave dhe ndërtesave të afërta;

c) Dëshminë e pronësisë, përmes certifikatës së pronësisë nga regjistri i të drejtave në pronën e paluajtshme ose dëshminë e të drejtës së shfrytëzimit të tokës, përmes pëlqimit të pronarëve ose kontratës që i mundëson parashtruesit të kërkesës të bëjë kërkesë për ndërrim të destinimi;

d) Përshkrimi i hollësishme e projektit, përfshirë kërkesat që kanë të bëjnë me ujin, rrymën elektrike, lidhjet e kanalizimit dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis si dhe sistemet e afërta të ujitjes;

e) Deklarata komunale për lidhjen e mundshme në infrastrukturën teknike;

f) Parashtruesi i kërkesës do të deklaroj se ndërtimi i propozuar duhet të bëhet në lokacionin për të cilin ka parashtrua kërkesë pasi që ajo tokë nuk shfrytëzohet për bujqësi dhe/ose nuk ka tokë bujqësore të klasës më të ulët se toka për të cilën është kërkuar ndërrimi i destinimit ose ajo nuk është e përshtatshme për ndërtim;

g) Në rast të kërkesës për ndërrim të përkohshëm të destinimit, duhet të dorëzohet projekti për ri-kultivim, sipas Udhëzimit Administrativ për Ri-kultivim të Tokës Bujqësore.

Dokumentet e kërkuara sipas Pikave a), c), d) dhe g) të këtij neni, duhet të dorëzohen në tri kopje.

Neni 11

Ndërrimi destinues I tokës bujqësore me qëllim të shfrytëzimit të gurëve, vendosjes së mbeturinave të hedhura etj bëhet në pajtim me Vendimin e Kuvendit komunal.

Vendimin për ndryshimin e kulturës së tokës e merr organi komunal kompetent për punët në bujqësi, kurse ndryshimin e kulturës e bënë organi komunal I administratës kompetent për punët e gjeodezisë.

Neni 12

Personave të cilëve u lejohet ndërtimi I objekteve ekonomike, të banimit dhe I objekteve të tjera të standardit shoqëror do të paguajnë kompensimin për njësi të" sipërfaqes sipas Vendimit mbi caktimin e taksave komunale.

Kompensimi nga alineja 1 e këtij neni bëhet në llogari të Buxhetit të KK Dragashit

Neni 13

Drejtorati për urbanizëm obligohet që me rastin e lëshuarës së Lejeve të ndërtimit paraprakisht të kërkojë nga parashtruesit e kërkesës Pëlqimin nga organi komunal kompetent për punët në bujqësi.

III DHËNJA ME QIRA E TOKES BUJQESORE

Neni 14

Pronaret te tokave bujqësore te cilët ne një mënyre apo tjetër nuk janë në gjendje te punojnë tokën bujqësore obligohen qe tokën bujqësore ta japin me qira atyre që dëshirojnë ta punojnë.

Dhënia e tokës bujqësore me qira bëhet me anën e kontratës, e cila kohëzgjatjen e ka varësisht nga kulturat bujqësore qe do te mbillen a janë njëvjeçare apo shumë vjeçare.

Toka e marr me qira nuk mund te i jepet personit tjetër ne shfrytëzim.

IV MBROJTJA E TOKES BUJQESORE

1 .Mbrojtja nga erozioni

Neni 15

Toke bujqësore e rrezikuar nga erozioni konsiderohet toka ne të cilën për shkak të ndikimit te ujit dhe te erës bëhet shpërlaja e fortë e gërmimeve dhe hapjeve të hullive etj.

Neni 16

Masa kundër erozionit përcaktohen :

-Ndalesat e përkohshme ose të përhershme te rilavrimit të livadheve dhe kullotave dhe shndërrimin e tyre ne ara me të mbjella njëvjeçare.

-Mbjellja e kulturave shumëvjeçare,

-Ndalimi i kullotjes se bagëtisë për një kohe te caktuar etj.

Neni 17

2. Pengimi i dëmeve te fushës

Me qellim të mbrojtjes se pasurive bujqësore dhe te lashtave ndalohet:

-Lëshimi dhe kullotja e kafshëve ne pasurit e huaja bujqësore para se te mblidhen frutat,

-Lëshimi dhe kullotja e kafshëve ne pronën e huaj qe është kopsht, pemishte, livadh artificial, jonxhe, tërfoje, vend i ri i pyllëzuar dhe kultura tjera te ngjashme gjatë tere vitit,

-Thyerja dhe shkatërrimi i pemishteve nga pasuria e huaj,

-Mbledhja e frutave nga pemishtja e huaj

-Vjedhja dhe dëmtimi i mjeteve te huaja bujqësore,

-Shkulja, kositja, korrija dhe dëmtimi i të lashtave dhe kulturave tjera bujqësore dhe marrja e frutave nga pasuria e huaj,

-Lëshuarja e shtazëve-shpezëve ne pasuritë e huaja bujqësore para se të jen hequr frutat, etj.

V SHERBIMI I MBROJTJES SE PASURIVE BUJQESORE

Neni 18

Shërbimin për mbrojtjen e pasurive bujqësore e organizojnë vet qytetaret e fshatrave ne tubimet qe i organizojnë ata vet.

Vendbanimet për juridiksionin e vet (sipërfaqen e vet) caktojnë rojtarin e fushës, rajoni I cili mbrohet, lartësia e pagesës së rojtarit të fushës dhe kushtet tjera për të cilën deklarohen qytetaret.

Neni 19

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do te kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Inspeksion,Turizëm dhe Zhvillim Rural.

VI DISPOZITAT NDESHKIMORE

Neni 20

Me dënim ne te holla prej 500 - 1000 € do te dënohet personi për kundërvajtje te nenit 12 te kësaj Rregulloreje.

Neni 21

Me dënim ne te holla prej 100-200 € do te dënohet personi për kundërvajtje te të gjitha alineve te nenit 17.

Neni 22

Rregullorja hyn ne fuqi ditën e miratimit nga asambleja komunale

VII DISPOZITAT PERFUNDIMTARE

Neni 23

Kjo Rregullore vlen deri ne prurjen e Ligjit apo ndonjë Rregullore nga instancat me te larta.

Kryesuesi i KK –së
Lulzim Rifaj
